

Shqipëria dhe Kosova: Cila është e ardhmja?

Dekonstruktimi i idesë së bashkimit



Organizatata që zbatojnë projektin

- **Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare (AIIIS)**

AIIIS është një institut jo-qeveritar, jo-fitimprurës, i themeluar ne 2003 dhe i angazhuar në punë kërkimore dhe zhvillime politikash. AIIIS është një nga institucionet akademike më të besuara nga politike-bërësit shqiptarë dhe partnerët ndërkombëtarë në fushat e studimit të sigurisë, demokracisë, integrimin Euro-Atlantik dhe bashkëpunimit rajonal. AIIIS ka për qëllim të prodhojë raporte, analiza dhe rekomandime politikash bashkëkohore mbi sfidat me të cilat përballen politikbërësit shqiptarë dhe aktorë të tjere të shoqerise.

- **Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)**

KIPRED-i është instituti parë hulumtues joqeveritar i themeluar në Kosovën e pasluftës në vitin 2002. Ai ka për fokus të punës së tij hulumtuese politikat e jashtme dhe të sigurisë, me theks të posaçëm në Evropën Juglindore; marrëdhëniet ndër-etnike në Kosovë dhe regjion; shtetin ligjor dhe partitë politike në Kosovë.

AIIIS dhe KIPRED, si organizatat më prestigjioze në Shqipëri dhe Kosovë në trajtimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe atyre të Evropës Juglindore, kanë zgjedhur që të ndërtojnë partneritet me njëra tjetrën në zbatimin e këtij projekti hulumtues



Qëllimi i projektit

Kontribut në trasimin e debatit politik në Kosovë dhe Shqipëri për përmirësimin dhe thellimin e marrëdhënieve strategjike dypalëshe, duke përfshirë edhe zbërthimin e idesë së bashkimit të tyre.



Objektivat e projektit

- Intensifikimi i bashkëpunimit në mes të organizatave të shoqërisë civile të Kosovës dhe Shqipërisë në trajtimin e temave të interesit publik
- Vlerësim kritik i marrëdhënieve të tanishme dhe të ardhme politike në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.
- Shqyrtim i mundësive dhe kufizimeve për idenë e bashkimit të dy vendeve që rrjedhin nga rendet kushtetuese vendore, e drejta ndërkombëtare, integrimet dhe antarësimi në strukturat Euro-Atlantike
- Ngritja e nivelit të debatit për opcionet realiste të zhvillimit të marrëdhënieve strategjike në mes dy vendeve.



Metodologjia

- ❑ Desk Hulumtimi
- ❑ Hulumtimi i literaturës shkencore dhe asaj publicistike
- ❑ Intervistat me rreth 35 politikanë, zyrtarë shtetëror, akademik, shoqëria civile dhe gazetarë nga Kosova e Shqipëria, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e komuniteteve minoritare.
- ❑ Draftimi i kapitujve të parapërcaktuar nga ekspertë të AIIIS e KIPRED, dhe komentimi i tyre nga ekipet hulumtuese të të dyja organizatat.



Rezultatet e pritura

- Intensifikimi i bashkëpunimit në mes të organizatave joqeveritare në Kosovë dhe Shqipëri përmes hulumtimeve dhe avokimeve të përbashkëta për çështjet e bashkëpunimit në mes dy vendeve.
- Publikimi i përbashkët i AIIIS dhe KIPRED” “Shqipëria dhe Kosova: Cila është e ardhmja - Dekonstruktimi i idesë së bashkimit” si dhe prezantimi i tij në Tiranë dhe Prishtinë.
- Vendimmarrësve politik nacional do ju ofrohet një analizë për marrëdhëniet politike Kosovë – Shqipëri, si dhe rekomandimet përkatëse për zhvillimin strategjik të marrëdhënieve dypalëshe që mund t’ju shërbejnë për të ri-shqyrtuar dhe ri-dizajnuar politikat e tyre në raport me njëra tjetrën, me regjionin dhe më gjerë.
- Vendimmarrësve politik nacional dhe opinionit publik do ju prezantohet një dekonstruktiv gjithëpërfshirës i idesë së bashkimit të dy vendeve, që mund të ketë ndikim thelbësor për të ardhmen e marrëdhënieve bilaterale në mes Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe të ardhmes së tyre Euro-Atlantike.



Komunikimi i rezultateve

- Publikimi i Punimit të AIIIS dhe KIPRED në gjuhën shqipe dhe angleze.
- Prezantimi publik dhe diskutimi i rezultateve në Tiranë dhe Prishtinë.
- Organizimi i debateve televizive në Tiranë dhe Prishtinë për rezultatet e hulumtimit me qëllim të sensibilizimit të opinionit publik për nivelin dhe opsionet e bashkëpunimit në mes Kosovës dhe Shqipërisë.

- **Rezultatet e hulumtimit do të shpërndahen tek:**

Institucionet vendëse qeveritare dhe parlamentare, Mediumet vendore, Organizatat e shoqërisë civile , Përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar në Kosovë dhe Shqipëri, Raportuesve për Kosovën dhe Shqipërinë në Parlamentin Evropian si dhe Komisionit për Punë të Jashtme të BE-së, Shërbimin e Jashtëm të BE-së, Drejtoratit Gjeneral të Komisionit Evropian për Fqinjësi dhe Zgjerim, Kabinetit të Sekretarit Gjeneral të NATO-s.

- **Rezultatet e hulumtimit do ju prezentohen:**

Organizatave të shoqërisë civile, komunitetit akademik dhe mediave në Kosovë dhe Shqipëri në konferencat përkatëse prezentuese në Prishtinë dhe Tiranë, Komisioneve Parlamentare të Politikës së Jashtme dhe përfaqësuesve të institucioneve qeveritare vendore në Kosovë dhe Shqipëri.



FALEMNDERIT PËR VËMENDJE

